

## Përmbajtja:

- 1: Hyrje
- 2: Veprimtari kryesore
- 3: Formimi Fillestar
- 4: Formimi Vazhdues
- 5: Agjenda e muajit qershor

## Të nderuar,

Ju prezantojmë me numrin e pestë të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, mbi veprimtarinë e saj akademike dhe administrative gjatë muajit maj.

## Formimi Fillestar Zemra e magjistratëve të rinj

### Muaji maj

Muaji maj ishte një muaj i mbushur me aktivitete akademike dhe institucionale. Muaj që shënoi fituesit që do të ndjekin vitin akademik 2026-2027, në profilin gjyqtar, prokuror, avokat shteti dhe ndihmës ligjor. Kandidatët fitues për profilin gjyqtar, prokuror dhe avokat shtetit iu nënshtruan edhe testit psikologjik me shkrim dhe me gojë.



**Neni 18 i Rregullores së Brendshme të SHM-së: 4. "Komisioni i shëndetit mendor dhe psikologjik ngrihet nga Këshilli Drejtues në bashkëpunim me Ministrinë e**

*Shëndetësisë, i përbërë nga dy mjekë psikiatër dhe dy psikologë. Një pedagog i brendshëm i Shkollës së Magjistraturës merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet e këtij komisioni gjatë gjithë vlerësimit."*

## Aktivitetet e muajit

- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- 4-7 maj vizitë studimore e kandidatëve të vitit të tretë në Akademinë Studimore ERA dhe në Gjykatën e Drejtësisë së BE-së.
- 7 maj 2026, ministri i Drejtësisë së Francës, z. Gerald Darmanin zhvilloi një takim në formë bashkëbisedimi me studentët dhe stafin akademik të Shkollës së Magjistraturës.
- 8 maj 2026 – shpallja e rezultateve të provimit të pranimit për profilin gjyqtar, prokuror dhe avokat shteti.
- 8 maj 2026 – aktivitet me rastin e ditës së drejtësisë
- 9 maj 2026 – vlerësimi përfundimtar në lëndën gjykimi familjar, i mituri dhe viktimi.
- 8 maj 2026 – vlerësimi përfundimtar në lëndën gjykimi kushtetues.
- 19 maj 2026 zhvillimi i provimit të pranimit për kandidatët për ndihmës ligjor.
- 22 maj 2026 shpallja e rezultateve të provimit të pranimit për profilin ndihmës ligjor.
- 26 maj 2026 vlerësimi në modulën "Aftësitë për prezantimin e çështjes në gjykatë dhe drejtimin e seancës gjyqësore".
- Zhvillimi i kursit me karakter praktik "Klinika ligjore".
- Zhvillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë të vitit të dytë.
- Përmbyllja e javës së fundit të gjyqeve imituese nga kandidatët e vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata.

## Viti i parë

Gjatë muajit maj krahas mësimit në auditor u zhvillua vlerësimi përfundimtar në gjykimin kushtetues, gjykimin familjar dhe në modulën “Aftësitë për prezantimin e çështjes në gjykatë dhe drejtimin e seancës gjyqësore”.



Çaste nga vlerësimi në gjykimin familjar maj 2026

Kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor vazhdojnë krahas mësimit edhe praktikën në gjykata e prokurori.

## Viti i dytë

### Zhvillimi i gjyqeve imituese

Gjatë muajit maj 2026, kandidatët për magjistratë të vitit të dytë zhvilluan gjyqe imituese penale dhe civile, duke trajtuar çështje komplekse të së drejtës materiale dhe procedurale.

Në gjyqin imitues penal të **Grupit I** u trajtua vepra penale e “Plagosjes së rëndë me dashje” në bashkëpunim, me fokus te papërdorshmëria e deklarimeve të të pandehurit, ligjshmëria e përgjimeve,

vlerësimi i provave dhe indicieve, si dhe administrimi i ekspertimit.

**Grupi II** zhvilloi një gjyq penal mbi veprën penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, ku u debatua mbi dallimin ndërmjet motiveve pasurore dhe atyre personale, kualifikimin juridik të veprës, si dhe individualizimin e dënimit.

Në gjyqin penal të **Grupit III**, bazuar në ngjarjen e Potamit, Himarë, u trajtuan çështje që lidhen me administrimin e provave, ekspertimet, lidhjen shkakësore, dallimin ndërmjet dashjes eventuale dhe pakujdesisë, si dhe përgjegjësinë penale në drejtimin e mjeteve lundruese.

Në fushën civile, **Grupi IV** trajtoi një çështje që lidhej me legjitimitimin e personit të tretë në paditë sipas nenit 585 të Kodit të Procedurës Civile, duke diskutuar gjithashtu marrjen e provave, pohimin gjyqësor dhe kushtet për ngritjen e kësaj padie.

**Grupi V** zhvilloi një gjyq civil në fushën e pronësisë industriale, lidhur me konfliktin mbi pronësinë e një marke tregtare, duke analizuar regjistrimin në keqbesim, kundërpadinë, ekspertimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale.

Ndërsa **Grupi VI** trajtoi një mosmarrëveshje civile mbi njohjen e pronësisë së një pasurie objekt kontrate sipërmarrjeje, duke analizuar efektet juridike të kontratës, kalimin e pronësisë, vlefshmërinë e kontratave të mëvonshme dhe mbrojtjen e të drejtave të blerësit.



*“Risia e gjyqeve imituese të zhvilluara gjatë muajit maj ishte përfshirja e nxënësve të gjimnazit “Sami Frashëri” në to, së bashku me kandidatët për magjistratë. Ata morën role aktive dhe kontribuan në diskutime mbi çështje civile e penale. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e drejtësisë dhe afrimin e të rinjve me sistemin gjyqësor.*”



## Orari për muajin maj

MUAJI QERSHOR													
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 34	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	6	7	
8:30 – 11:20	Kontrat6	MG/D4		Puna2	Puna2	GJTK3							
11:20 – 14:50		ASHL4	Vlerësim	Mjedial	GJTK3		Vlerësim	Puna	ASHL4				
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 35	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	13	14	
8:30 – 11:20	Vlerësim		MG/D6	ASHL8	GJTK6	MG/D6	ASHL8	GJTK6	Vlerësim	MG/D			
11:20 – 14:50	Kontrat6												
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 36	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	20	21	
8:30 – 12:20	ASHL8	GJTK6	GJTK6	ASHL8	ASHL	GJTK	GJTK	ASHL	ASHL4	GJTK3			
12:20 – 13:00									GJTK3	ASHL4			
13:00 – 16:40													
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 37	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	27	28	
8:30 – 11:20	ASHL8	GJTK6	GJTK6	ASHL8	ASHL4	GJTK6	GJTK6	ASHL4	Vlerësim	ASHL			
11:20 – 14:50													
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 38	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 – 11:20	Vlerësim	GJTK											
11:20 – 14:50													

## Viti i tretë

Në bashkëpunim me Akademinë e të Drejtës Evropiane (ERA), kandidatët e vitit të tretë të profilit prokuror zhvilluan një vizitë studimore në ERA dhe në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian gjatë datave 4–7 maj 2026. Vizita kishte si qëllim thellimin e njohurive mbi të drejtën e BE-së dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, përmes diskutimeve mbi Urdhrin Evropian të Ndalimit, ekstradimin, skuadrat e përbashkëta hetimore, digjitalizimin dhe provat elektronike.

Gjatë vizitës, kandidatët ndoqën një seancë gjyqësore dhe zhvilluan takime me ekspertë të njohur, duke përfituar një përvojë të vlefshme profesionale. Aktiviteti kontribuoi në forcimin e kompetencave për zbatimin e së drejtës së BE-së, njohjen e standardeve evropiane të drejtësisë dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.



## Aktivite të institucionale

Më 7 maj, Ministri francez i Drejtësisë, Gérald Darmanin, Zhilin një vizitë në Shkollën e Magjistraturës, ku u takua me drejtuesit kryesorë të sistemit të drejtësisë. U vlerësua bashkëpunimi me Francën dhe u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi mes dy shkollave të magjistraturës.





Vizita u mbyll me një bashkëbisedim me studentë dhe përfaqësues të institucioneve mbi shtetin e së drejtës, integrimin evropian dhe sigurinë

## Konkursi Ndërkombëtar THEMIS 2026

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Gjyqësor Evropian të Trajnimeve, në datat 25-29 maj 2026, Shkolla e Magjistraturës, edhe këtë vit, mori pjesë në konkursin ndërkombëtar e-THEMIS në gjysëm finalen D Etika Profesionale. Konkursi u zhvillua në qytetin e Trier-it, Gjermani.

Në këtë aktivitet, skuadra e Shkollës së Magjistraturës përbëhej nga Emiljana Kane, kandidate për magjistrate e vitit të tretë dhe Iva Balza dhe Dorisa Ruda, kandidate për magjistrate në vitin e dytë të studimeve, nën mentorimin e pedagogut Dr. Ildir Peçi. „The Catwalk Judge“ ishte punimi me të cilën u prezantua Shkolla e Magjistraturës në konkursin e këtij viti.

Punimi i realizuar dhe prezantuar nga skuadra e Shkollës u vlerësua si punim shumë i mirë nga anëtarët e jurisë dhe më konkretisht vlerësimi i marrë ishte për një punë origjinale me strukturë shumë të qartë, me rrjedhim logjik nga fakti tek legjislacioni dhe zgjidhja e rastit. Me vlerë u konsiderua edhe mënyra krijuese e prezantimit të punimit të përgatitur dhe konsultimi ndërmjet anëtarëve të skuadrës në dhënien e përgjigjeve të mirë-menduara.



## Formimi Vazhdues

Gjatë muajit maj 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 19 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 389 pjesëmarrës (numër total pjesëmarrjesh).

Aktivitetet trajnuese të muajit maj 2026 u zhvilluan në kuadër të moduleve:

- **Dënimi penal dhe alternativat e tij** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Shqyrtimi gjyqësor i aktit administrativ**– [grupi i synuar, gjyqtarë administrativë]
- **Dhuna me bazë gjinore**– [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Prova dhe mjetet e kërkimit të provës në procesin penal** - [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Dhuna me bazë gjinore** - [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj, përmbaues]
- **Provat në procesin civil** - - [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]

- **Trajnime të posaçme 1-2 ditore si “Trajnim mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht duke u përqendruar në çështjet e pronësisë”, në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit; “Trajnim në lidhje me vendimet e gjykatës së lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore (të cilat datojnë nga viti 2018 e në vijim), të grupuara këto trajnime për sa i përket llojit të çështjeve civile/penale/administrative”; “Funksioni i Gjykatës Administrative të Apelit dhe i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në kontrollin e vlefshmërisë së akteve normative nënligjore; “Drejtesia digjitale në Bashkimin Evropian. Koncepte dhe zhvillime rregullatore”, në bashkëpunim me EIPA”.**

Moduli **“Dënimi penal dhe alternativat e tij”** u zhvillua me një pjesëmarrje të gjerë dhe interes të veçantë nga prokurorë dhe OPGj, në datat 4, 5 dhe 18 maj 2026. Trajtimi i këtij moduli u fokusua në trajtimin e parimeve dhe praktikave bashkëkohore të individualizimit të dënimit, zbatimit të alternativave ndaj burgimit si dhe standardeve të jurisprudencës vendase dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Gjatë aktivitetit u diskutuan çështje praktike mbi efektivitetin e masave alternative, rolin e tyre në rehabilitimin e të dënuarve dhe rëndësinë e proporcionalitetit në caktimin e dënimit penal, duke nxitur shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet pjesëmarrësve.



Foto 1. Aktivitet trajnues, datë 4 maj 2026  
Foto 2. Aktivitet trajnues, datë 18 maj 2026

Moduli **“Shqyrtimi gjyqësor i aktit administrativ”**, u zhvillua në datat 7, 8 dhe 26 maj 2026, duke u fokusuar në analizën e standardeve ligjore dhe jurisprudenciale që lidhen me kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative. Gjatë aktivitetit u trajtuan çështje që lidhen me ligjshmërinë e akteve administrative, garantimin e të drejtave të palëve në procesin administrativ gjyqësor, si dhe praktika e gjykatave administrative në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës. Moduli ngjalli interes të gjerë dhe u ndoq nga gjyqtarë, administrative, ndihmës dhe këshilltarë ligjorë.





Foto 3. Aktivitet trajnues, datë 7 maj 2026  
Foto 4. Aktivitet trajnues, datë 8 maj 2026

Moduli “Prova dhe mjetet e kërkimit të provës në procesin penal” u zhvillua në datat 26 dhe 28 maj 2026, duke u fokusuar në trajtimin e standardeve procedurale dhe praktikave bashkëkohore që lidhen me administrimin e provës në procesin penal. Gjatë aktiviteteve trajnuese u diskutuan çështje që lidhen me vlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave, respektimin e të drejtave themelore gjatë mbledhjes së tyre, si dhe përdorimin e mjeteve speciale të kërkimit të provës në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet e jurisprudencës ndërkombëtare. Moduli ngjalli interes të gjerë dhe u ndoq nga gjyqtarë, prokurorë, ndihmës magjistratë dhe profesionistë të tjerë të sistemit të drejtësisë, duke nxitur diskutime mbi sfidat praktike dhe garantimin e një procesi të rregullt ligjor.



Foto 5. Aktivitet trajnues, datë 26 maj 2026  
Foto 6. Aktivitet trajnues, datë 27 maj 2026

Në datat 19 dhe 20 maj 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi në bashkëpunim me UNDP, dy tema trajnuese të modulit “**Dhuna me Bazë gjinore**”. Këto aktivitete trajnuese u fokusuan në aksesin e grave në drejtësi, të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe trajtimin me ndjeshmëri gjinore të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Gjatë trajnimit u trajtuan standardet e legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar, detyrimet që burojnë nga Istanbul Convention, rekomandimet e GREVIO dhe CEDAW për sistemin e drejtësisë, si dhe praktika e European Court of Human Rights lidhur me format e dhunës me bazë gjinore dhe masat mbrojtëse për viktimat. Vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të psikologut dhe punonjësit social në garantimin e aksesit efektiv në drejtësi dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturve, si dhe zbatimit të masës së largimit të menjëhershëm të dhunuesit nga banesa, në funksion të mbrojtjes së të mbijetuarave të dhunës dhe praktikave të dëmshme.



Foto 7. Aktivitet trajnues, datë 19 maj 2026

Foto 8. Aktivitet trajnues, datë 20 maj 2026

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin e binjakëzimit (Twinning), Shkolla e Magjistraturës zhvilloi trajnimin 2-ditor, me temë “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, me fokus të veçantë në çështjet e mbrojtjes së të drejtës së pronës. Aktiviteti u mbështet edhe nga ekspertizë ndërkombëtare, duke mundësuar trajtim të thelluar të standardeve të European Convention on Human Rights dhe të praktikës gjyqësore të European Court of Human Rights, me theks të veçantë në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe zbatimin e tij në çështjet e pronësisë.



Foto 9. Aktivitet trajnues, datë 18-19 maj 2026

## Metodologjia e aktiviteteve trajnuese

Trajnimet u realizuan duke ndërthurur prezantimet (deri në 20-30 min) me diskutimin e çështjeve të shtruara (pyetjeve vetë studimore; pyetje-përgjigje) dhe ushtrimeve me raste praktike & kuize, për të nxitur dhe realizuar ndërveprimin aktiv të pjesëmarrësve.

Për muajin **qershor** janë planifikuar:

- **24 aktivitete trajnuese të formimit vazhdues**

Ju ftojme të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,  
**Shkolla e Magjistraturës**

[www.magjistratura.edu.al](http://www.magjistratura.edu.al)

E-mail: [info@magjistratura.edu.al](mailto:info@magjistratura.edu.al)



## AGJENDA E MUAJI QERSHOR

### Kalendari i trajnimeve

Qershor 2026				
1.	<b>MODUL b.6 “PROVAT NË PROCESIN CIVIL”</b> Aktet e ekspertimit si provë shkresore. Kushtet e vlefshmërisë, përdorshmërisë dhe papërdorshmërisë së tyre në procesin gjyqësor. Procesi i të provuarit gjatë gjykimit civil dhe veçoritë e aktit të ekspertimit si provë.		<b>Ekspertë:</b> Dritan Caka Irida Kaçerja <b>Lehtësues:</b> Olti Skrame	<u>1 qershor</u> <u>2026</u>
2.	<b>Trajnim 1-ditor</b> Hartimi i Arsytimit Ligjor për Prokurorë  (Trajnim i dedikuar për prokurorë)	Në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit	<b>Ekspertë:</b> Fulvio Baldi Gianluigi Pratola Jaane Maaik TAHAPARY Anne TAHAPARY	<u>1 qershor</u> <u>2026</u>
3.	<b>MODUL a. 16 “DHUNA ME BAZË GJINORE”</b> Zbatimi i ndalimit me ligj të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes me fokus LGBTIQ+ .  Efikasiteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore. Efektiviteti i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe procedimet në rast të shkeljes së tyre.	Bashkëpunim me UNDP	<b>Ekspertë:</b> Matilda Fetau Ornela Naqellari <b>Lehtësues:</b> Adnan Hoxha	<u>2 qershor</u> <u>2026</u>
4.	Dhuna në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Ndryshimet e dispozitës dhe raporti me ligjin për dhunën në familje. Interpretimi i termave “gjini e afërt” dhe “krushqi e afërt”. Praktikant e ndryshme gjyqësore lidhur me rrethin e pjesëtarëve të familjes që janë subjekt i veprës penale të dhunës në familje. Interpretimi i rrethanës cilësuese “më shumë se njëherë” dhe “në praninë e fëmijëve” sipas paragrafit të katërt të nenit 130/a të Kodit Penal. Parashikimet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore.	Bashkëpunim me QNL	<b>Ekspertë:</b> Valbona Vata Marjeta Zaimi <b>Lehtësues:</b> Gëzim Spahiu	<u>3 qershor</u> <u>2026</u>
5.	Aktivitet trajnues pan-evropian mbi ligjin e BE-së për barazinë gjinore.	ERA	<b>Ekspertë:</b> Aida Bushati  Arta Mandro	<u>4-5 qershor</u> <u>2026</u>

6.	<p><b>MODUL a.16 “DHUNA ME BAZË GJINORE”</b></p> <p>Dhuna me bazë gjinore ndaj grave.</p> <p>Efikasiteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore. Efektiviteti i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe procedimet në rast të shkeljes së tyre.</p> <p>Problematikat në praktikën gjyqësore lidhur me deklarin e viktimave të dhunës se nuk kërkojnë ndjekje penale përveç pajisjes me urdhër mbrojtje dhe qëndrimi i organit procedues. Detyrimi i gjykatës për referimin e rasteve në organin procedues.</p> <p>Mbrojtja e viktimës së dhunës me bazë gjinore.</p> <p>Efekti i procedimeve penale lidhur me dhunën në familje mbi vendimmarrjet e gjykatës për zgjidhjen e martesës dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës</p>	Bashkëpunim me UNDP	<p><b>Ekspertë:</b></p> <p>Vjosa Zaimi Anita Pilika</p> <p><b>Lehtësues:</b></p> <p>Eliora Elezi</p>	8 qershor 2026
7.	<p>Dhuna digjitale - shkeljet e kryera në internet, të tilla si zbulimi i informacionit privat dhe ‘cyberflshing’</p> <p>Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 1 i Grevio për dimensionin digjital të dhunës ndaj grave miratuar më 20 tetor 2021.</p> <p>Rregullat e BE-së për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - dhuna kibernetike, ndihma për viktimat dhe hapa për të parandaluar përdhunimin.</p>	Bashkëpunim me QNL	<p><b>Ekspertë:</b></p> <p>Ylli Pjetërnikaj Denisa Asko</p> <p><b>Lehtësues:</b></p> <p>Mediana Meta</p>	9 qershor 2026
8.	<p><b>Trajnim 2-ditor</b></p> <p>Hetimi financiar proaktiv i rasteve komplekse të pastrimit të parave</p> <p><i>(Trajnim i dedikuar vetëm për prokurorë)</i></p>	Në bashkëpunim me KE	<p><b>Ekspert SHM</b></p> <p>Elion Mustafaj</p> <p>Ekspertë KE:</p> <p>Maurizio Varanese Silvia Martinez Canton</p>	9-10 qershor 2026
9.	<p><b>ToT</b></p> <p>Trajnim Trajnerësh mbi nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – e drejta për liri dhe siguri.</p>	Në bashkëpunim me KE	<p><b>Ekspert SHM</b></p> <p>Dritan Hallunaj</p>	10-12 qershor 2026
10.	<p><b>MODUL c.6</b></p> <p><b>“SHQYRTIMI GJYQËSOR I AKTIT ADMINISTRATIV”</b></p> <p>Marrëdhënia ndërmjet juridiksionit administrativ dhe juridiksionit kushtetues.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kufijtë e kontrollit të Gjykatës Kushtetuese mbi vendimet e Gjykatës së Lartë dhe rrezikun e shndërrimit të saj në instancë të katërt.</li> </ul>		<p><b>Ekspertë:</b></p> <p>Sokol Sadushi Arta Vorpsi</p>	10 qershor 2026



	<ul style="list-style-type: none"><li>- Funkzioni kushtetues I Gjykatës së Lartën ë sistemin gjyqësor përballë funksionit të Gjykatës Kushtetuese.</li><li>- Rëndësia e dialogut ndërgjyqësor dhe efekti i vendimeve të Gjykatës së Lartë si pjesë e interpretimit të brendshëm të ligjit.</li><li>- Qasja evropiane mbi ndarjen e funksioneve ndërmjet gjykatës më të lartë dhe gjykatës kushtetuese.</li></ul>			
11.	<b>Trajnim 3-ditor</b> Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale ( <i>online</i> )	Në bashkëpunim me Shkollën Italiane të Magjistraturës	<b>Ekspertë nga SSM</b>	10 – 12 qershor 2026.
12.	<b>Trajnim 2-ditor</b> Hetimi financiar proaktiv i rasteve komplekse të pastrimit të parave  ( <i>Trajnim i dedikuar vetëm për prokurorë</i> )	Në bashkëpunim me KE	<b>Ekspert SHM</b> Elida Kaçkini <b>Ekspertë KE:</b> Maurizio Varanese Silvia Martinez Canton	11.-12 qershor 2026
13.	<b>Trajnim 1 ditor</b> Shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Veçoritë e vendimit të gjyqtarit të hetimeve paraprake, seancës paraprake dhe gjyqtarit të themelit në raport me kërkesat e palëve si refleksion i arsytimit në pavarësinë e gjykatës.  ( <i>Trajnim për KLGJ</i> )		<b>Ekspertë:</b> Amarildo Laçi Idlir Peçi <b>Lehtësues:</b> Marinela Osmani (Nuni)	11 qershor 2026
14.	<b>Trajnim 1 ditor</b> Mbi aftësitë menaxheriale të Kryetarëve të Gjykatave me qëllim përshtatjen e rolit të tyre me Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë ( <i>Trajnim për KLGJ</i> )		<b>Ekspertë:</b> Iliba Bezati Emona Muçi	15 qershor 2026
15.	<b>MODUL a.17 “TRAFIKIMI”</b> Trafikimi i qenieve njerëzore, personave të rritur e të mitur. Kuadri ligjor ndërkombëtar i zbatueshëm, jurisprudenca e GJEDNJ. Kuadri ligjor kombëtar dhe format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Praktika gjyqësore e njehsuar e KPGJL. Pozicioni procedural i viktimeve të trafikimit gjatë hetimeve, të drejtat procedurale, mbështetja dhe trajtimi gjatë gjykimit të çështjeve.		<b>Ekspertë:</b> Miliana Muça Anita Jella <b>Lehtësues:</b> Ervisa Hyka	16 qershor 2026



16.	<b>Hetimi dhe ndjekja penale e veprave penale me armë zjarri.</b> Respektimi i kushteve dhe kriterëve të caktimit të masave të sigurimit për veprën penale "Posedimi dhe prodhimi i paautorizuar i armëve, eksplozivëve dhe municionit":		<b>Ekspertë:</b> Ylli Pjetërnikaj Olgert Rumnici <b>Lehtësues:</b> Gjergji Ceka	17 qershor 2026
17.	<b>Trajnim 1 ditor</b> Kompetencat e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm lidhur me çështje të veçanta të procedurës së arbitrazhit; emërimi i arbitrave kur palët nuk bien dakord; marrja e masave të përkohshme kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende; shqyrtimi i kërkesës për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit.		<b>Ekspertë:</b> Dashamir Kore Flutura Kola <b>Lehtësues:</b> Borana Mustafaraj	18 qershor 2026
18.	<b>MODUL a.17 TRAFIKIMI</b> Trafikimi i qenieve njerëzore, personave të rritur dhe të mitur. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Format e kryerjes së veprës penale të trafikimit. Risetë në pozicionin procedural të viktimave. Metodikat, teknikat e posaçme në kryerjen e hetimeve të trafikimit. Identifikimi dhe intervistimi i viktimave. Specifikat e intervistimit të të miturve, viktimave të trafikimit.		<b>Ekspertë:</b> Elida Kaçkini Saida Dollani <b>Lehtësues:</b> Vitjuna Mata	22 qershor 2026
19.	<b>Trajnim 1 ditor</b> Platformat e GJEDNJ-së që ndihmojnë në njohjen me jurisprudencën e këtij institucioni (si HUDOC dhe ECHR Knowledge Sharing platform) <i>(trajnim i dedikuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë)</i>	<u>Bashkëpunim me KE</u>	<b>Ekspertë:</b> Aida Bushati	23 qershor 2026
20.	<b>Trajnim 1 ditor</b> Trajnim i dedikuar për shkrimin, kërkimin dhe arsyetimin ligjor apo çështje të tjera të administrimit gjyqësor me fokus njësinë ligjore në bashkëpunim me SHM. <i>(Trajnim për KLGJ)</i>	<u>Në bashkëpunim me OSBE</u>	<b>Ekspertë:</b> Sokol Berberi Edlira Petri <b>Lehtësues:</b> Ina Hoxhaj	<u>24 qershor 2026</u>

